



VENDIM

Nr. 65, Datë 27.05.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
“RREGULLORES PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL PËR TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 16; 47; 83 dhe 85 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” VKM Nr. 244 Datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 27.05.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Konstatoi se:

- Pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për “kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” me Nr. 244, Datë 30.03.2016, ERE në zbatim të nenit 14 pika 2 të këtij vendimi ngarkohet me detyrimin e miratimit të kësaj Rregullore.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për vendosjen e detyrimit të shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike në Shqipëri”.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI